



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT DHE SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2021

Lënda: Kthim përgjigje

Znj._____

Në vijim të kërkesës suaj për informacion ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

➤ **A ka bashkia juaj zyrë për viktimat e dhunës në familje?**

Bashkia Shkodër ka në përbërjen e saj Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik, e cila është drejtori e krijuar për herë të parë në Bashkinë e Shkodrës në fillim të vitit 2016.

Vizioni i kësaj drejtorie është “Shërbime Sociale multisektoriale, të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit, në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë”.

Struktura e kësaj drejtorie përbëhet nga 2 sektorë si më poshtë:

1. Sektori i Përfshirjes Sociale, Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Strehimit.
2. Sektori i Planifikimit Strategjik, Standarteve e Monitorimit për Shërbimet sociale dhe Shëndetin Publik, i cili është edhe sektori që mbulon çështjet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Shërbimet me bazë komunitare të cilat filluan të krijohen gjatë vitit 2016 janë të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Qendrat Komunitare “Për Familjen” janë njësitë bazë të ngritura dhe që mbulojnë me shërbime sociale çdo lagje të qytetit dhe njësitë administrative.

Aktualisht janë të ngritura dhe në funksion 12 qendra komunitare; 7 në zonën urbane dhe nga një në Njësitë Administrative të Gurit të Zi, të Dajçit, Velipojës, Postribës, Rrethinave. Në këto

qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizim ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komuniteti, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, etj.

Gjatë punës sonë përveç qendrave komunitare “Për Familjen” që ofrojnë shërbime sociale bazë në një territor të përcaktuar kemi arritur të ndërtojmë qendra që ofrojnë shërbime të specializuara për grupe dhe individë në nevojë të tilla si: qendra komunitare Multifunksionale në shërbim të fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge; qendra Rinore Atelie, në shërbim të të rinjve; qendra komunitare “Për Familjen” nr.6 me apartamente sociale për jetimët dhe familjet me njëkryefamiljar dhe fëmijë.

➤ **Sa persona janë të punësuar në bashkinë tuaj në lidhje me këtë çështje?**

Drejtoria e Shërbimeve Sociale Strehimit dhe Shëndetit Publik pranë Bashkisë Shkodër përbëhet nga 23 persona staf, afërsisht 11 nga këto janë të përfshirë direkt me detyra specifike në çështjet e dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore.

➤ **Sa raste të grave/vajzave që kërkojnë ndihmë pasi janë dhunuar në familje keni pasur në 2 vitet e fundit?**

Viti	Raste
2019	61 raste
2020	81 raste
2021(janar-shkurt)	26 raste

➤ **Sa prej këtyre grave/vajzave u është dhënë ndihmë ekonomike? Sa është kjo ndihmë?**

Të gjithë rastet e dhunës në familje të pajisura me UM përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike. Specialistët pranë qendrave komunitare “Për Familjen” informojnë çdo rast të pajisur me UM për pagesën që me ligj ju takon dhe orientojnë/ asistojnë për procedurën përkatëse që duhet të ndjekin për ta përftuar atë.

Gjatë kësaj periudhe kanë aplikuar dhe përftuar këtë pagesë 58 gra. Pagesa që përftohet është 3 000 lekë.

➤ **Sa është e pranishme dhuna ndaj grave që i referohet ankesave apo kërkesave për ndihmë në bashkinë Shkodër për vitin 2020 dhe këto muaj të vitit 2021? Numri i tyre. Sa kërkesa keni trajtuar ?**

Bashkia Shkodër përgjatë vitit 2020 ka trajtuar, menaxhuar dhe monitoruar 121 raste të dhunës në familje. Përpos rasteve të reja të vitit 2020 gjatë vitit ka vazhduar edhe menaxhimi dhe monitorimi i urdhërave të mbrojtjes që kanë qenë në fuqi nga viti 2019. Ndërsa përgjatë muajve janar-shkurt 2021 janë trajtuar, menaxhuar dhe monitoruar 26 raste të dhunës në familje.

Për të gjithë rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.

Çdo rast i trajtuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie, është trajtuar në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës dhe në bashkëpunim me institucionet / OSHC-të pjesë të MKR-së. Pavarësisht vështirësive janë dhënë shërbimet e nevojshme në varësi të problematikave të konstatura.

➤ **Cilat janë problematikat që ndeshen?**

Problematikat dhe sfidat janë të shumta sepse çdo rast i dhunës në marrëdhëniet familjare është unik dhe specifik, duke evidentuar nevoja dhe problematika të ndryshme nga rasti në rast.

Disa nga sfidat dhe nevojat kryesore më të cilat hasemi në punën tonë të përditshme dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje janë:

- Bashkëpunimi ndërinstytucional në disa raste dhe marrja e përgjegjësive sipas legjislacionit në fuqi nga secili prej anëtarëve të MKR-së.
- Fuqizimi socio-ekonomik dhe riintegrimi në shoqëri i viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare të çdo forme qofshin ato.
- Strehimi afatgjatë i viktimave të dhunës në familje dhe kapacitetet e kufizuara të strehimit emergjent.
- Kapacitetet e kufizuara njerëzore, infrastrukurore, burimet financiare të limituara dhe të munguara në shumicën e rasteve.
- Ngritja, financimi dhe qëndrueshmëria e shërbimeve komunitare në zonat rurale, që përbëjnë edhe shumicën e njësive administrative në territorin e bashkisë së Shkodrës mbetet vështirësia më e madhe për shërbime cilësore e të qëndrueshme. Megjithë detyrimin ligjor të kontributit qeveritar për financimin e shërbimeve sociale në përgjithësi dhe të shërbimeve direkte për administrimin e mbrojtjes e të integritit të rasteve të

dhunës në marrëdhëniet familjare, deri tani këto shërbime realizohen dhe financohen vetem me financimin e Bashkisë Shkodër dhe të donatorëve e OJQ. Për rrjedhojë financimi e qëndrueshmëria e shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore në nivel vendor mbetet sfida më e rëndësishme në implementimin e SKBGJ.

- **Çfarë ndihme i jep bashkia atyre grave që i drejtohen për ndihmë, në cilat drejtime jepet kjo ndihmë. Sa prej tyre e kanë marrë këtë ndihmë?**

Në zbatim të ligjit Nr.9669, dt.18/12/2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar me Ligjin Nr.47/2018, si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e proçedimit të tij” :

Bashkia e Shkodrës ka krijuar dhe vënë në funksion Qendrat Komunitare “Për Familjen”; Aktualisht janë në funksion 12 qendra; 7 në zonën urbane dhe 5 në njësitë administrative. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitetit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, ofrohen shërbime për familjet në vështirësi socio-ekonomike, vulnerabël ndaj fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe gjithashtu janë trajtuar dhe mbështetur viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ofruar shërbime sipas nevojave specifike të secilit rast.

Bashkia Shkodër përgjatë vitit 2020 ka trajtuar, menaxhuar dhe monitoruar 121 raste të dhunës në familje. Përpos rasteve të reja ka vazhduar menaxhimi dhe monitorimi i urdhërave të mbrojtjes që kanë në fuqi nga muajt e mëparshëm (viti 2019).

Për të gjithë rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.

Në varësi të nevojave viktimat e dhunës në familje, kanë marrë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga stafi i Qendrave Komunitare “Për familjen” të Bashkisë Shkodër dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në Bashkinë Shkodër.

Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 kujdesi i stafit ndaj viktimave të dhunës në familje ka qenë i shtuar. Komunikimi është realizuar përmes telefonit dhe në rastet e nevojshme janë realizuar edhe vizitat në familje në bashkëpunim me SPZ-të e zonës, me të cilët bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë.

Në rastet e nevojshme, pas vlerësimit të situatës dhe nevojave është realizuar edhe mbështetja e rasteve me pako ushqimore dhe higjeno-sanitare.

Në kuadër të ndërgjegjësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, Bashkia Shkoder ka realizuar një sërë aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore gjatë vitit. Janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendari të paracaktuar. Janë organizuar 16 aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Në vazhdimësi përgjatë këtyre muajve janë organizuar edhe 19 aktivitete të tjera me fokus parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe trafikimin e qenieve njerëzore. Në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore janë zhvilluar 10 aktivitete sensibilizuese, informuese nën moton “Heshtja nuk të mbron! Dëgjo, Beso, Mbështet!”. Aktivitetet janë organizuar nën masa të kujdesit të shtuar dhe në respektim të të gjithë masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Gjatë aktiviteteve verore të organizuara me fëmijët në qendrat komunitare “Për Familjen” është folur për format e ndryshme të dhunës dhe mënyrat e raportimit të saj. Krahas këtyre aktiviteteve, fushatat e komunikimit online, me qëllim rritjen e informimit dhe sensibilizimit të komunitetit për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, janë organizuar vazhdimisht përgjatë të gjithë kësaj periudhe me anë të postimeve në mediat sociale të Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Përgjatë gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID-19 janë shpërndarë poste me informacionin e nevojshëm se ku mund të kërkohet ndihmë dhe kontaktet e nevojshme. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

Në faqen e facebook-ut të Drejtorisë së Shërbimeve, Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik gjeni të publikuar edhe çdo aktivitet sensibilizues të organizuar nga Bashkia Shkodër për parandalimin e dhunës.

<https://www.facebook.com/Drejtoria-e-Sh%26%20Arbimeve-Sociale-Strehimit-dhe-Sh%26%20ndetit-Publik-Shkod%26%20Ar-207655856280284/>

➤ **Cila është mënyra e bërjes së kërkesës për ndihmë në rastet e dhunës?**

Ndihma mund të kërkohet përmes formave të ndryshme: direkt në vendbanimin përkatës, duke u drejtuar tek Qendra Komunitare “Për Familjen” përkatëse; pranë ZIN të Bashkisë Shkodër; pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik të Bashkisë Shkodër; pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër; në Nr.129; në linjën kombëtare 116 117, e cila më pas bën referimin përkatës; pranë organizatave të shoqërisë civile që operojnë në nivel lokal apo kombëtar.

➤ **A ndihmohen financiarisht gratë e dhunuara dhe në rast se po sa është buxheti për këtë?**

Fondi në dispozicion për ofrimin e shërbimeve konsiston në kostot për paga dhe sigurime për stafin (3,648 mijë lekë) dhe kosto operative (660 mijë lekë) për funksionimin e qendrave komunitare “Për Familjen”, të cilat menaxhojnë drejtpërdrejtë rastet e dhunës në familje.

Të gjithë rastet e dhunës në familje të pajisura me UM përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike. Secila prej rasteve informohet për pagesën që me ligj ju takon dhe orientohet për procedurën përkatëse që duhet të ndjekë për ta përfituar atë.

Gjatë kësaj periudhe kanë aplikuar dhe përfituar këtë pagesë 58 gra. Pagesa që përfitohet është 3 000 lekë.

Buxheti në dispozicion të aktiviteteve ndërgjegjësuese në lidhje me dhunën me bazë gjinore, për vitin 2020 ka qënë i ndarë në këto zëra:

1. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. (200 mijë lekë).
2. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore. (200 mijë lekë).
3. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi (150 mijë lekë).

➤ **Sa është numri i urdhërave të mbrojtjes së lëshuar nga gjykata për gratë e dhunuara në bashkinë Shkodër?**

Bashkia Shkodër ka menaxhuar dhe trajtuar gjithsej gjatë vitit 2020, 55 UMM dhe 66 UM të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

➤ **A funksionon shërbimi në ndihmë të grave të dhunuara në të gjithë territorin që mbulon bashkia Shkodër?**

Bashkia e Shkodrës, gjatë 4 viteve të fundit i ka kushtuar rëndësi të vecantë çështjeve gjinore dhe dhunës në familje, duke i integruar në të gjitha programet dhe funksionet e saj.

Disa nga aktivitetet dhe arritjet në fushën e barazisë gjinore dhe dhunës në familje që mund të përmendim janë:

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës që nga viti 2015 është krijuar dhe vënë në funksion strehëza për rastet emergjente të dhunës me bazë gjinore.

Bashkia e Shkodrës ka krijuar dhe vënë në funksion Qendrat Komunitare “Për Familjen”; Aktualisht janë në funksion 12 qendra; 7 në zonën urbane dhe 5 në njësitë administrative. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe

familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitetit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, ofrohen shërbime për familjet në vështirësi socio-ekonomike, vulnerabël ndaj fenomenit të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe gjithashtu janë trajtuar dhe mbështetur viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ofruar shërbime sipas nevojave specifike të secilit rast.

Bashkia e Shkodrës ka nënshkruar Kartën Evropiane në 8 Mars 2017, duke e bërë atë pjesë të dokumentave dhe instrumentave që orientojnë veprimet dhe hapat që ndërmerren në të gjitha aspektet e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Menjëherë pas marrjes së këtij angazhimi publik, i gjithë stafi i Bashkisë Shkodër është angazhuar maksimalisht për zbatimin në praktikë të Kartës Evropiane.

Përveç përkushtimit për hartimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020 për një periudhë realativisht të shkurtër kohore, Bashkia Shkodër caktoi në buxhetin e saj vjetor një zë dhe fonde përkatëse pikërisht për aktivitete për zbatimin e Kartës Evropiane.

Gjatë vitit 2018, si hap i parë i zbatimit në praktikë të Kartës Evropiane për Barazi të burrave dhe grave në jetën vendore Bashkia e Shkodrës ka përgatitur dhe miratuar planin e veprimit për Barazinë Gjinore. Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore, mbulon një tërësi fushash dhe në të parashikohen veprime që synojnë: respektimin e të drejtës themelore të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve; trajtimin e çështjeve të pabarazive dhe diskriminimit; veprime për eliminimin e stereotipeve gjinore; pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në vendim-marrjen politike e publike; aksesin në shërbime të ndryshme të hartuara sipas nevojave të veçanta të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve me cilësi e në respektim të parimeve të barazisë; integrimin e këndvështrimit gjinor në të gjitha planet dhe fushat për zhvillim të qëndrueshëm; planifikimin e mbështetur në burimet e duhura, etj.

Në zbatim të ligjit nr.139/2015, “Për Vetqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”(i ndryshuar) , i ndryshuar me Ligjin Nr.47/2018, neni 8, pika 8 e tij; si dhe të VKM nr. 334, datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”, Bashkia e Shkodrës gjatë vitit 2017, ka koordinuar dhe nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për riorganizimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga të gjitha institucionet publike që veprojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës me rastet e dhunës në familje dhe gjithashtu organizatat e shoqërisë civile që janë aktive dhe veprojnë në territor me këtë target grup. Bashkëpunimi midis këtyre institucioneve dhe organizatave përgjatë viteve ka qenë i mirë. Të gjithë aktorët i janë përgjigjur në kohë nevojës për veprim dhe menaxhim të rasteve. ETN mblidhet ad-hoc, në varësi

të rasteve të dhunës në familje dhe problematikave që paraqet çdo rast konkret, ose brenda 24-48 orëve ose brenda javës kur është identifikuar rasti. Ky ekip mblidhet me kërkesën e institucionit, pjesë e mekanizmit, i cili ka identifikuar rastin. (psh; policia, organizata, Bashkia, qendrat komunitare). Në momentin që paraqitet një rast dhune, bëhet vlerësimi fillestar për të parë nivelin e riskut në të cilin ndodhet viktimja. Më pas bëhet vlerësimi i detajuar, sipas nevojave që paraqet rasti, mblidhet ETN, ndahen rolet e përgjegjësitë. Pas vlerësimit të nevojave të çdo rasti, hartohet plani i punës dhe për çdo shërbim të specializuar vlerësohen mundësitë dhe kapacitetet fillimisht nga institucionet, pjesë e mekanizmit dhe në rast se këto institucione nuk i ofrojnë, kërkohet mbështetja nga partnerë të ndryshëm privatë apo publikë.

Çdo rast, që trajtohet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale e Bashkisë së Shkodrës, si dhe Qendrat Komunitare “Për Familjen”, pjesë e kësaj drejtorie, trajtohet në zbatim të plotë me legjislacionin përkatës.

Bashkia e Shkodrës ka një traditë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile. Një nga objektivat e saj është partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese me qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në vazhden e traditës së mirë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile Bashkia Shkodër ka bashkëpunuar ngushtë edhe me organizatat ndërkombëtare të tilla si: UNDP dhe UN WOMEN, si dhe organizata të tjera si: organizata Gruaja te Gruaja, Terre Des Hommes Albania, Hapat e Lehtë, Albanian Disability Rights Foundation, Papa Giovanni XXIII, World Vision, Nisma për ndryshim shoqëror, Hope for the World, Gender Alliance for Development Center për çështjet e dhunës me bazë gjinore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Voltana Ademi